

RELACION

PËR

MIRATIMIN E KRITEREVE, DOKUMENTACIONIT DHE PROCEDURAVE PËR CERTIFIKIMIN E VEPRIMTARISË SË AGROTURIZMIT DHE NDËRTIMIN E STRUKTURAVE/OBJEKTEVE NË FUNKSION TË TIJ, SI DHE MIRATIMIN E MODELIT TË CERTIFIKATËS

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Hartimi i këtij projektvendimi vjen në zbatim të pikës 3, të nenit 45/1 të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, i ndryshuar, i cili parashikon se kriteret, dokumentacioni dhe procedurat për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Projektvendimi synon krijimin e një kuadri të plotë, të unifikuar dhe bashkëkohor për zhvillimin e veprimtarisë së agroturizmit në Republikën e Shqipërisë, duke përcaktuar kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për certifikimin e veprimtarisë, ndërtimin e strukturave në funksion të saj, procedurat për dhënien, ripërtëritjen, pezullimin dhe shfuqizimin e certifikatave, si dhe modelin e certifikatës për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

Objektivat kryesore të projektvendimit janë:

- zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale nëpërmjet integritit të turizmit me aktivitetet bujqësore, blegtorale, të peshkimit dhe akuakulturës;
- rritja e investimeve në zonat rurale dhe krijimi i mundësive të reja të punësimit;
- promovimi i produkteve vendase dhe forcimi i lidhjes ndërmjet turizmit dhe prodhimit lokal;
- mbrojtja dhe promovimi i identitetit rural, traditave lokale dhe trashëgimisë kulturore;
- krijimi i një sistemi të qartë dhe transparent certifikimi;
- reduktimi i barrës administrative për subjektet që ushtrojnë ose synojnë të ushtrojnë veprimtarinë e agroturizmit;
- forcimi i mekanizmave të monitorimit dhe kontrollit të subjekteve të certifikuara.

Agroturizmi përfaqëson një nga instrumentet më efektive për zhvillimin ekonomik dhe social të zonave rurale, duke krijuar vlerë të shtuar për prodhimin vendas dhe duke kontribuar në diversifikimin e ofertës turistike kombëtare.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi është në përputhje me Programin Politik të Këshillit të Ministrave për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, mbështetjen e sipërmarrjes rurale dhe promovimin e turizmit gjithëvjetor. Ai kontribuon drejtpërdrejt në politikat kombëtare për:

- zhvillimin e turizmit rural;
- nxitjen e investimeve në zonat rurale;
- rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve vendase;
- zhvillimin e ekonomisë lokale;
- përfshirjen e të rinjve dhe grave në sipërmarrje rurale.

Gjithashtu, projektvendimi mbështet objektivat strategjike për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe forcimin e lidhjes ndërmjet sektorit të turizmit dhe sektorit agro-ushqimor.

Miratimi i këtij projektvendimi është parashikuar në programin analitik të akteve të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për vitin 2026.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektvendimi propozohet si një domosdoshmëri ligjore dhe funksionale në zbatim të ndryshimeve të bëra në ligjin nr. 93/2015 “Për turizmin”, të ndryshuar, i cili ka përcaktuar se kriteret, dokumentacioni dhe procedurat për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Në këtë kuadër, është bërë e nevojshme rishikimi i plotë i kuadrit nënligjor ekzistues, me qëllim krijimin e një sistemi të unifikuar dhe të qartë për zhvillimin e veprimtarisë së agroturizmit.

Përvoja e zbatimit të kuadrit aktual ka evidentuar një sërë problematikash që kanë ndikuar në zhvillimin e sektorit. Ndër to përfshihen fragmentimi i

rregullimeve në disa akte të ndryshme nënligjore, mungesa e një qasjeje të unifikuar për certifikimin, procedurat administrative relativisht të ndërlikuara, si dhe mungesa e rregullimeve të detajuara për monitorimin, pezullimin dhe shfuqizimin e certifikatave.

Gjithashtu, kuadri ekzistues nuk pasqyron në mënyrë të plotë zhvillimet e reja të sektorit rural dhe format e ndryshme të aktivitetit ekonomik që sot kontribuojnë në ofertën e agroturizmit.

Në këtë kontekst, projektvendimi synon të krijojë një kuadër më fleksibël dhe më gjithëpërfshirës, duke zgjeruar kategoritë e subjekteve që mund të ushtrojnë veprimtarinë e agroturizmit. Krahas fermave bujqësore dhe blegtorale, përfshihen edhe njësitë e akuakulturës, peshkimit, përpunimit agro-ushqimor, si dhe forma të tjera të veprimtarive agrokulturore, të cilat përbëjnë një potencial të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të zonave rurale. Ky zgjerim reflekton evolucionin e sektorit dhe nevojën për të krijuar mundësi më të mëdha për investime dhe diversifikim ekonomik.

Një tjetër element i rëndësishëm i projektvendimit është rikonceptimi i veprimtarisë pritëse dhe i strukturave në funksion të agroturizmit. Përveç akomodimit, ushqimit dhe pijeve, parashikohen edhe aktivitete kulturore, edukative, degustimi, promovimi i produkteve lokale dhe shërbime të tjera të lidhura me identitetin rural dhe traditat vendase.

Në të njëjtën kohë, akomodimi nuk konsiderohet më kusht i detyrueshëm për ushtrimin e veprimtarisë së agroturizmit, çka krijon mundësi që edhe ferma apo njësi prodhuese më të vogla të mund të certifikohen dhe të bëhen pjesë e ofertës turistike rurale.

Projektvendimi forcon gjithashtu lidhjen ndërmjet turizmit dhe prodhimit vendas, duke përcaktuar kritere të qarta për origjinën e produkteve ushqimore të përdorura në subjektet e certikuara. Kjo qasje synon të garantojë autenticitetin e përvojës agroturistike, të mbështesë fermerët dhe prodhuesit lokalë, si dhe të rrisë vlerën e shtuar që turizmi gjeneron për ekonominë rurale.

Për herë të parë parashikohen edhe mekanizma konkretë për verifikimin dhe dokumentimin e origjinës së produkteve, duke rritur transparencën dhe besueshmërinë e sistemit.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm lidhet me procedurat për ndërtimin dhe zhvillimin e strukturave në funksion të agroturizmit. Projektvendimi harmonizon këto procedura me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, si dhe me legjislacionin sektorial në fushën e bujqësisë, duke krijuar një kuadër më të qartë për investitorët dhe autoritetet përgjegjëse.

Gjithashtu, ai adreson raste të veçanta që lidhen me zhvillimin e veprimtarive në toka bujqësore, si dhe krijon bazën për trajtimin e rasteve të zhvillimit të agroturizmit në fondin pyjor, kullosor apo në zona të mbrojtura, në përputhje me legjislacionin përkatës sektorial.

Projektvendimi sjell gjithashtu përmirësime të rëndësishme në aspektin procedural, duke dixhitalizuar të gjithë procesin e aplikimit dhe shqyrtimit nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, duke përcaktuar qartë kompetencat e Komisionit të Certifikimit të Veprimtarisë së Agroturizmit, si dhe duke vendosur procedura të detajuara për monitorimin, pezullimin dhe shfuqizimin e certifikatave. Këto mekanizma synojnë të rrisin transparencën, sigurinë juridike dhe efektivitetin e administrimit të skemës së certifikimit.

Në tërësi, projektvendimi pritet të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin e sektorit të agroturizmit, duke rritur numrin e subjekteve të certifikuara, duke nxitur investimet në zonat rurale, duke forcuar formalizimin e aktivitetit ekonomik, si dhe duke krijuar një lidhje më të fortë ndërmjet turizmit, bujqësisë, blegtorisë, peshkimit dhe akuakulturës.

Nëpërmjet këtyre masave, pritet të rritet cilësia dhe diversiteti i ofertës turistike shqiptare, të krijohen vende të reja pune dhe të kontribuohet në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social të komuniteteve rurale.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës dhe ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, i ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk synon përafrim me *acquis* e BE.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi “Për miratimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit, ndërtimin e strukturave/objekteve në

funksion të saj, si dhe modelit të certifikatës për ushtrimin e veprimtarisë së agroturizmit” përbëhet nga shtatë kre dhe një shtojcë, të cilat rregullojnë në mënyrë të plotë kriteret, procedurat dhe mekanizmat administrativë për certifikimin, monitorimin dhe zhvillimin e veprimtarisë së agroturizmit.

Kreu I – Dispozita të Përgjithshme

Ky kre përcakton objektin e vendimit, parimet mbi të cilat mbështetet ushtrimi i veprimtarisë së agroturizmit, si dhe përkufizimet bazë që përdoren në të gjithë aktin.

Në këtë kre përcaktohet se agroturizmi bazohet në integrimin e veprimtarive turistike me aktivitetin bujqësor, blegtoral, të peshkimit, akuakulturës dhe veprimtarive të tjera agrokulturore, me synim zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale, promovimin e produkteve vendase dhe ruajtjen e identitetit rural. Gjithashtu, sanksionohet se vetëm subjektet e certifikuara sipas këtij vendimi kanë të drejtë të përdorin emërtimin “Agroturizëm”.

Në vijim jepen përkufizimet e strukturës pritëse, veprimtarisë pritëse, fermës, certifikatës paraprake, certifikatës, komisionit të certifikimit, sekretariatit teknik, produkteve me origjinë nga ferma, produkteve lokale dhe subjektit që mund të ushtrojë veprimtarinë e agroturizmit.

Kreu II – Kriteret për Certifikimin e Veprimtarisë Pritëse si “Agroturizëm” dhe Ndërtimin e Strukturave/Objekteve në Funksion të Agroturizmit

Ky kre përcakton kriteret bazë që duhet të plotësojnë subjektet për t’u certifikuar si agroturizëm.

Në të parashikohen kategoritë e fermave dhe njësive që mund të zhvillojnë veprimtari agroturizmi, duke përfshirë fermat bujqësore, fermat blegtorale dhe njësitë e akuakulturës. Gjithashtu përcaktohen kriteret minimale për sipërfaqet, numrin e kafshëve, numrin e zgjojeve apo sipërfaqet ujore që duhet të disponohen për secilën kategori.

Kreu rregullon gjithashtu kushtet që duhet të plotësojnë subjektet që zhvillojnë veprimtari përpunuese agro-ushqimore, shërbimet që mund të ofrohen në kuadër të agroturizmit, kriteret për strukturat e ushqimit dhe pijeve, si dhe kriteret për akomodimin kur ky ofrohet si pjesë e veprimtarisë.

Një pjesë e rëndësishme e këtij kreu lidhet me përcaktimin e origjinës së produkteve ushqimore të përdorura nga subjektet e certifikuara, duke vendosur përqindjet minimale të produkteve me origjinë nga ferma dhe prodhuesit lokalë, si dhe dokumentacionin që përdoret për verifikimin e tyre.

Gjithashtu, kreu përmban rregulla të detajuara lidhur me ndërtimin e strukturave në funksion të agroturizmit, përputhshmërinë me dokumentet e planifikimit vendor, procedurat për pajisjen me leje zhvillimi dhe leje ndërtimi, si dhe procedurat që ndiqen në rastet kur mungojnë planet e përgjithshme vendore. Në këtë kuadër përcaktohet edhe roli i Agjencisë së Zhvillimit të Territorit dhe i njësive të vetëqeverisjes vendore në procesin e shqyrtimit të projekteve.

Kreu III – Kërkesa dhe Dokumentacioni për Certifikimin e Veprimtarisë së Agroturizmit

Ky kre rregullon procedurat dhe dokumentacionin që duhet të paraqitet nga subjektet për pajisjen me Certifikatë Paraprake ose Certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së agroturizmit.

Përcaktohet se aplikimi kryhet nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, si dhe dokumentacioni që duhet të paraqitet për secilin lloj certifikimi.

Për Certifikatën Paraprake kërkohet dokumentacioni që lidhet me zhvillimin dhe ndërtimin e projektit të agroturizmit, përfshirë lejen e zhvillimit, projektin teknik dhe relacionin shpjegues mbi aktivitetin bujqësor ose agrokulturor.

Për Certifikatën përfundimtare përcaktohen dokumentet që provojnë pronësinë ose të drejtën e përdorimit të pasurisë, certifikimin e strukturës akomoduese kur është e aplikueshme, dokumentacionin për aktivitetet e akuakulturës dhe peshkimit, si dhe dokumentacionin që lidhet me aktivitetin prodhues dhe veprimtaritë argëtuese ose edukative të ofruara nga subjekti.

Gjithashtu, kreu përcakton dokumentacionin që sigurohet në mënyrë automatike nga institucionet publike nëpërmjet sistemeve të ndërveprimit elektronik, duke reduktuar barrën administrative për subjektet aplikuese.

Kreu IV – Procedura e Shqyrtimit të Kërkesës

Ky kre rregullon organizimin, përbërjen dhe funksionimin e Komisionit të Certifikimit të Veprimtarisë së Agroturizmit, si dhe procedurën administrative për shqyrtimin e kërkesave.

Përcaktohet përbërja e Komisionit, kompetencat e tij, mënyra e funksionimit, rregullat e mbledhjeve, procesi i vendimmarrjes dhe rastet e konfliktit të interesit.

Gjithashtu, përcaktohen hapat proceduralë që ndiqen nga momenti i paraqitjes së kërkesës deri në marrjen e vendimit për lëshimin ose refuzimin e Certifikatës Paraprake apo Certifikatës, përfshirë procedurat për plotësimin e

dokumentacionit, verifikimet në terren, afatet e shqyrtimit dhe mënyrën e njoftimit të subjektit.

Kreu përmban gjithashtu dispozita për bashkërendimin e procedurave të certifikimit të agroturizmit me procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese, si dhe përcakton mekanizmat e monitorimit të subjekteve të certifikuara nga inspektorati përgjegjës për turizmin në bashkëpunim me institucionet e tjera kompetente.

Kreu V – Pezullimi dhe Shfuqizimi i Certifikatave

Ky kre përcakton rastet, procedurat dhe pasojat e pezullimit dhe shfuqizimit të Certifikatës Paraprake dhe Certifikatës.

Në të rregullohen procedurat që ndiqen kur konstatohet mosplotësimi i kriterëve ose shkelja e kushteve të përcaktuara në vendim, duke garantuar të drejtën e subjektit për t'u informuar, për të paraqitur shpjegime dhe për t'u dëgjuar përpara marrjes së vendimit.

Gjithashtu, përcaktohen rastet kur certifikata mund të shfuqizohet, si deklarimi i të dhënave të rreme, mosplotësimi i kriterëve pas pezullimit ose shkeljet e përsëritura të dispozitave të vendimit.

Kreu rregullon gjithashtu pasojat juridike të shfuqizimit të certifikatës, përfshirë humbjen e statusit të subjektit të certifikuar dhe procedurat që ndiqen në rastet kur subjekti ka përfituar mbështetje publike ose përfitime fiskale në bazë të certifikimit.

Kreu VI – Miratimi i Modelit të Certifikatës dhe Vlefshmëria

Ky kre përcakton elementet përbërëse të Certifikatës Paraprake dhe Certifikatës, mënyrën e lëshimit të tyre, afatet e vlefshmërisë, procedurat për shtyrjen e afatit të Certifikatës Paraprake dhe procedurat për ripërtëritjen e Certifikatës.

Në këtë kre përcaktohet se certifikatat lëshohen në formë elektronike përmes portalit “e-Albania”, regjistrohen në Regjistrin Qendror të Turizmit dhe afishohen në ambientet e subjektit.

Gjithashtu, rregullohen afatet e vlefshmërisë së certifikatave, procedurat që ndiqen kur subjekti nuk përfundon ndërtimin brenda afatit të certifikatës paraprake, si dhe procedurat për ripërtëritjen periodike të certifikatës për subjektet që vazhdojnë të përmbushin kriteret e përcaktuara në këtë vendim.

Kreu VII – Dispozita Përfundimtare

Ky kre përcakton institucionet përgjegjëse për zbatimin e vendimit, dispozitat kalimtare për subjektet që janë pajisur me Certifikatë Paraprake sipas kuadrit ekzistues, si dhe aktet nënligjore që shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

Në mënyrë të veçantë, parashikohet shfuqizimi i Vendimit nr. 22, datë 12.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të tij”, të ndryshuar, si dhe i Urdhrit nr. 15, datë 15.1.2024, të ministrit përgjegjës për turizmin, duke konsoliduar të gjithë kuadrin rregullator të certifikimit të agroturizmit në një akt të vetëm të Këshillit të Ministrave.

Shtojca 1

Shtojca 1 përmban modelet e miratuara të Certifikatës Paraprake për Veprimtarinë Pritëse Agroturizëm dhe të Certifikatës për Veprimtarinë Pritëse Agroturizëm, të cilat lëshohen në formë elektronike nga ministria përgjegjëse për turizmin.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është hartuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Për shkak të karakterit ndërsektorial të projektaktit, i cili rregullon çështje që lidhen me turizmin, bujqësinë, planifikimin dhe zhvillimin e territorit, mbrojtjen e mjedisit, sigurinë ushqimore, shëndetin publik, pushtetin vendor dhe digjitalizimin e shërbimeve publike, projektakti do t’u dërgohet për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes

Sociale, Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij projektakti nuk ka efekte financiare në buxhetin e shtetit dhe nuk do të sigurojë të ardhura buxhetore shtesë.

**MINISTRI I TURIZMIT
KULTURËS DHE SPORTIT
BLENDI GONXHJA**

**MINISTRI I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
ANDIS SALLA**